



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot: \_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

EDUKIMIT

Prezantuar me:	30.06.2026		
Mi qytet:	Junist	Shtojca:	Vlera
04	1650	-	-

6

Pozita e shpallur në thirrje:

Lëndët:

Psikologji e edukimit, Proceset Psikike dhe Personaliteti (BA, Fillor); Proceset psikike dhe kognicioni (BA, Teknologji Arsimore), Psikologjia e edukimit (MA STEAM).

Kandidatët e paraqitur:

Argjentina Arifi, Arjeta Ahmedi, Bekrije Maxhuni, Cansel Safci, Diamanta Zogiani, Donjeta Geci, Elmaze Qerimi, Ernestinë Uka, Erëza Zaselja, Genta Jahiu, Miranda Lushaj Shala, Perihane Salihu, Valerije Kola, Valmir Shala

Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime

Thirrja për angazhim:

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar
4. Anëtar
5. Anëtar

Prof. TEUTA DANUZA

Prof. ALBULENA METAJ-MACULA

Prof. EDONA BERISHA-KIDA

Prof.

Prof.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata		Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese	Përvoja e punës profesionale në	Nota Ba.	Nota Ma.				
1.	Argentina Arifaj	MA			9.82	9.5		04.07.2000	/	JO	JO
2.	Ajeta Ahmed	MA			8.77	8.69		29.10.1986	/	JO	JO
3.	Bekrije Maxhuni	MA			8.02	8.80		06.12.1982	/	JO	JO
4.	Cansel Safçi	MA			2.07 (GPA)	3.66-3.77 (GPA)		27.11.2002	/	JO	JO
5.	Diamanata Zogiani	MA			9.26	9.07		27.07.1999	/	JO	JO
6.	Donjeta Geci	MA			9.20	9.81		25.12.1994	1	JO	JO

7.	Elmaze Qerini	MA			9.40	3.94 (GPA)		04.01.1995	/	JO	JO
8.	Ernestinë Uka	MA			9.67	Pass ëith Distin ction		18.02.1999	/	JO	JO
9.	Erëza Zaselja	MA			9.53	9.58		12.01.1999	/	JO	JO
10.	Genta Jahiu	MA			9.27	9.89		14.07.1996	6	JO	PO
11.	Miranda Lushaj Shala	MA			9.55 9.11-(MA2)	9.56		15.10.1995	/	JO	JO
12.	Perihane Salihu	MA			7.45	8.25		23.02.1979	/	JO	JO
13.	Valerije Kola	MA			9.23	8.95		06.06.1999	2	JO	JO
14.	Valmir Shala	BA			8.03	/		10.02.1995	/	JO	JO

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatit/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).*

1. **Argjentina Arifi** - Ka të përfunduar BA në Programin Fillor në Universitetin e Prizrenit “ Ukshin Hotin” , Fakultetin e Edukimit me notë mesatare 9.82 si dhe Master në Edukim Inkluziv në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit me notë mesatare 9.5. Nuk ka përvijë në mësimdhënie në Arsim të Lartë.
2. **Arjeta Ahmedi**- Ka të përfunduar studimet universitare në Psikologji në Universitetin shtetëror të Tetovës, Fakultetin e Filozofik me notë mesatare 8.77 si dhe Master në Psikologji në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik me notë mesatare 8.69. Ka përvijë profesionale si psikologe klinike. Po ashtu, ka të publikuara 2 punime shkencore . Nuk ka përvijë në mësimdhënie në Arsim të Lartë.
3. **Bekrije Maxhuni**- Ka të përfunduar BA në Psikologji në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik me notë mesatare 8.02 si dhe Master në Psikologji Klinike në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik me notë mesatare 8.80. Është kandidatë në studime të Doktoratës nga 05.2022, drejtimi Psikologji Organizative dhe e Punës në Universitetin Kliment Ohridski Sofie – Bullgari. Kandidatja ka paraqitur dëshmi për prezantime në konferenca dhe 1 (një) publikim shkencor. Kandidatja ka deklaruar përvijë 1 vit mësimdhënie në Arsim të Lartë, por nuk e ka të mbështetur me dëshmi relevante – ka dorëzuar vetëm letër rekomandimi dhe jo kontratë pune apo vendim të lëshuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë.
4. **Cansel Safci** - Ka të përfunduar BA në Shkenca Shëndetsore në Universitetin e Hacettepe, departamentin e Zhvillimit të Fëmijës dhe Master në Edukim – Arsim Special në Gezi University, Institutin e Shkencave të Edukimit. Ka përvijë profesionale në fushën e arsimit special. Po ashtu, ka paraqitur dëshmi për prezantime në konferenca shkencore dhe ka 1 publikim shkencor.
5. **Diamanta Zogiani** - Ka të përfunduar BA në Pedagogji të përgjithshme në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit me notë mesatare 9.26 si dhe Master në Pedagogji në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit me notë mesatare 9.07. Nuk ka përvijë në mësimdhënie në Arsim të Lartë.
6. **Donjeta Geci** – Ka të përfunduar BA në Psikologji (nota mesatare 9.20), dhe Master në Psikologji (Drejtimi: Shkollore dhe Këshillim) në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik, Departamenti i Psikologjisë (nota mesatare 9.81). Është kandidatë e studimeve të Doktoratës (Ph.D cand) ne vitin e trete te studimeve, në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Ljubjanës (programi: Teacher Education and Educational Science University of Ljubljana, Faculty of Education ). Ka 2 publikime shkencore dhe një kapitull libri në bashkëautorësi. Ka 1 vit përvijë në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit (grup lëndësh nga Psikologjia).
7. **Elmaze Qerimi** – Ka të përfunduar Bachelor në Psikologji në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik (Departamenti i Psikologjisë, nota mesatare 9.40) dhe MA në Psikologji (Drejtimi: Klinike dhe Zhvillimore, GPA 3.94) në Eötvös Loránd University, Faculty of Education and Psychology në Budapest, Institute of Psychology. Poashtu, është kandidatë

- e Doktorates (Ph.D cand) në Psikologji, në Ankara Yıldırım Beyazıt Üniversitesi. Nuk ka dëshmi për publikime shkencore. Nuk ka përvijë paraprake në mesindhënie në Arsim të Lartë.
8. **Ernestinë Uka** – Ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji (nota mesatare 9.67) në Universitetin e Prishtinës dhe Bachelor i Shkencave Shëndetësore në kolegjin Heimerer si dhe Master në King's College Londër, në Drejtimin Psikologji edhe Neuroshkencë e shendetit mendor (Pass with Distinction). Poashtu, posedon edhe një Master dytësor (Master i Shkencave në Logopedi nga Universiteti i Tiranës). Aktualisht është kandidat e studimeve të Doktoratës në University of Ljubljana & University of Pristina, në fushën: Shkenca të Edukimit – Edukim Inkluziv. Ka dy publikime shkencore, një si autore e parë në European Journal of Special Needs Education (Routledge) dhe një tjetër poashtu si autore e tretë. Nuk ka përvijë paraprake në mesindhënie.
9. **Erëza Zaselja** – Ka të përfunduara studimet Bachelor në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik në Departamentin e Psikologjisë (nota mesatare 9.53) dhe Master i Arteve në Psikologji Organizative dhe Sociale, nga Kolegji AAB (nota mesatare 9.58) dhe një Master në Pedagogji, nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit. Nuk ka përcjellur dëshmi të publikimeve shkencore. Nuk ka përvijë paraprake në mesindhënie.
10. **Genta Jahiu** – Ka të përfunduara studimet Bachelor në Psikologji (nota mesatare 9.27) në Universitetin e Prishtinës dhe Master në Shkencat e Psikologjisë-drejtimi: Psikologji Shkollore dhe Këshillim, në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik, Departamentin e Psikologjisë (nota mesatare 9.9). Është kandidat për titullin Doktor i shkencave në Edukim (PhD Cand.) në Universitetin e Lubljanës, Fakultetin e Edukimit, Programi: Edukimi i mesindhësor dhe Shkencat e Edukimit (viti i tretë i studimeve). Që nga viti 2019 është e angazhuar si asistente (bashkëpunëtorë e jashtëm) për grup lëndësh nga Psikologjia, nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Prishtinë. Numëron 7 publikime shkencore në Scopus dhe një kapitull libri (Book chapter si bashkëautorë).
11. **Miranda Lushaj Shala** -Ka të përfunduara studimet Bachelor në Edukim Fillor në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, me notë mesatare 9.55, si dhe studimet Master në Edukim Inkluziv në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 9.56. Po ashtu, ka përfunduar edhe studimet Master i Arteve në Menaxhment, me specializim në menaxhment dhe notë mesatare 9.11. Aktualisht është doktorante (Ph.D cand) në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit “Shën Kliment Ohridski” në Manastir, në programin Shkencat Arsimore. Kandidatja ka paraqitur dëshmi për publikime shkencore në revista dhe konferenca shkencore ndërkombëtare, ndër to dy punime të publikuara në Frontiers in Education. Gjithashtu ka dëshmi për pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
12. **Perihane Salihu** - Ka të përfunduar studimet Bachelor në Pedagogji të Përgjithshme në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me notë mesatare 7.45, si dhe studimet Master në Psikologji Organizative dhe Sociale në Kolegjin AAB, me notë mesatare 8.25. Kandidatja ka notën mesatare mbi 8 në studimet MA por jo dhe në ato BA. Kandidatja ka paraqitur

dëshmi për pjesëmarrje në trajnimet profesionale dhe posedon aftësi në organizim, menaxhim, bashkëpunim, hartim raportesh, punë ekipore dhe komunikim profesional.

13. **Valerije Kola** - Ka të përfunduara studimet Bachelor në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” me notë mesatare 9.23, si dhe studimet Master në Këshillim Pedagogjik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” me notë mesatare 8.95. Aktualisht është kandidatë për doktoratë (Ph.D cand) në Universitetin e Ljubljanes, në programin Shkencat e Edukimit. Kandidatja ka përvijë pune si bashkëpunëtorë e jashtëm (asistente për ushtrime) në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, ndërsa njëkohësisht ka ushtruar detyrën e mësimit në disa institucione të arsimit fillor, si dhe ka qenë mësimitdhënëse mbështetëse për fëmijë me nevoja të veçanta. Kandidatja ka paraqitur dëshmi për prezentime në konferenca.
14. **Valmir Shala** - Ka të përfunduara studimet Bachelor në Menaxhment në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetin Ekonomik, Departamenti i Menaxhmentit, me notë mesatare 8.03. Aktualisht është student i studimeve Master në Menaxhment në të njëjtin fakultet, viti i parë akademik 2024/2025.

## **Arsyetimi**

Komisioni Vlerësues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës, nenin 20, paragrafi 20.1, nënparagrafi 2.1 dhe nenin 147, paragrafi 3.9, si dhe në Rregulloren për Procedurat Vlerësuese për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm në Universitetin e Prishtinës, nr. prot. 2/2541, datë 17.07.2024, ka bërë vlerësimin e kandidatëve mbi bazën e meritës akademike dhe profesionale, në përputhje me kriteret e përcaktuara në konkursin publik. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime në lëndë: Psikologji e Edukimit, Proceset psikike dhe personaliteti (BA, Fillor); Proceset psikike dhe kognicioni (BA, Teknologji Arsimore), Psikologji e Edukimit (MA STEAM), komisioni vlerëson se kandidatja Genta Jahiu i plotëson më së miri kriteret akademike dhe profesionale për këtë pozitë. Kandidatja ka përfunduara studimet Bachelor në Psikologji me notë mesatare 9.27 dhe studimet Master në Psikologji Shkollore dhe Këshillim me notë mesatare 9.90, duke dëshmuar sukses të lartë akademik në fushën përkatëse. Aktualisht është kandidatë e studimeve të doktoratës (viti i tretë) në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Ljubljanes, në programin Teacher Education and Educational Sciences. Njëkohësisht,

kandidatja ka përvorjen më të gjatë në mësimdhënie në arsimin e lartë për këtë pozitë, pasi që nga viti 2019 është e angazhuar si bashkëpunëtoresh e jashtme në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës, pikërisht në grup lëndësh nga Psikologjia. Përveç kësaj, kandidatja posedon aktivitet të dalluar kërkimor-shkencor, me 7 publikime shkencore të indeksuara në Scopus dhe një kapitull libri në bashkautorësi.

Duke marrë në konsideratë përgatitjen akademike, rezultatet e larta në studime, vazhdimin e studimeve të doktoratës, përvorjen shumëvjeçare në ushtrime pikërisht në Fakultetin e Edukimit dhe aktivitetin e saj shkencor, komisioni vlerëson se Genta Jahiu është kandidatja më e kualifikuar për pozitën e lartpërmendur.

#### **Arsyetimi për kandidatët e tjerë**

**Donjeta Geci** – Është e kualifikuar në profilin përkatës (Psikologji), me rezultate të larta akademike dhe është kandidat e studimeve të doktoratës. Ka dy (2) publikime shkencore, bashkëtoresh e një kapitulli të një libri dhe ka një vit përvorje në Fakultetin e Edukimit. Megjithatë, kandidatja e përzgjedhur ka përvorje dukshëm më të gjatë (që nga viti 2019) në të njëjtin grup lëndësh dhe aktivitet shkencor më të gjërë.

**Argjentina Arifi** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji) dhe nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Arjeta Ahmedi** – Ka përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji) si dhe dy publikime shkencore. Megjithatë, nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Bekrije Maxhuni** – Ka përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji) dhe është kandidat e studimeve të doktoratës, mirëpo përvorja e deklaruar në arsimin e lartë nuk është deshmuar me dokumentacion përkatës. Gjithashtu aktiviteti shkencor është më i kufizuar krahasuar me kandidatën e përzgjedhur.

**Cansel Safci** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji) dhe nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Diamanta Zogjani** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji) dhe nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Elmaze Qerimi** – Ka përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji) dhe është kandidat e doktoratës, mirëpo nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë dhe nuk ka dëshmi për publikime shkencore.

**Ernesinë Uka** – Ka përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji) dhe publikime shkencore, mirëpo nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Erëza Zasella** – Ka përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji), mirëpo nuk ka përvorje në arsimin e lartë.



**Miranda Lushaj Shala** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji).

**Perihane Salihu** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji) dhe nuk plotëson kriterin e notës mesatare në studimet Bachelor, pasi nota mesatare është nën pragun e kërkuar.

**Valerije Kola** – Nuk ka përgatitje në profilin përkatës (Psikologji) dhe nuk ka përvorje në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Valmir Shala** – Nuk ka përfunduar ende studimet Master dhe nuk posedon përgatitjen në profilin përkatës (Psikologji).

Nënskkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

Pozita	Emri dhe mbiemri	Nënskrimi
Kryetar	TEUTA DRAMETI	
Anëtar	ALBULENA METAJ-MACUHA	
Anëtar	EDONA BERISHA KIDA	